Banka e Shqipërisë

ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË

T3 - 2022

Enian Çela
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

JANAR 2023

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

I.	*ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE*	*4*
II.	*LLOGARIA KORRENTE*	*5*
III.	*LLOGARIA KAPITALE*	*8*
IV.	*LLOGARIA FINANCIARE*	*8*
V.	*PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT*	*10*

I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE

Të dhënat e Bilancit të Pagesave në tremujorin e tretë të vitit 2022 tregojnë për një rritje të deficitit korrent në terma nominalë. Deficiti korrent është rritur ndjeshëm në terma vjetorë, nxitur nga zgjerimi i shpejtë i importeve dhe të ardhurave parësore dalëse. Flukset hyrëse të turizmit dhe të remitancave kanë ndikuar në kahun e kundërt, por pa qenë në gjendje të kompensojnë për efektin nga importet dhe të ardhurat parësore.

Deficiti i llogarisë korrente shënoi 166.6 milionë euro[1], duke u rritur me rreth 57.3% në terma vjetorë. Ai vlerësohet në 3.5% ndaj PBB-së, ose 0.8 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me një vit më parë. Rritja e importeve (31.0%) dhe më konkretisht rritja e importit të mallrave (29.8%) ka dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e deficitit. Rritja e importeve lidhet ngushtë me zgjerimin e fortë të çmimeve ndërkombëtare dhe importet e larta të energjisë elektrike. Në të njëjtin drejtim kanë ndikuar edhe të ardhurat parësore nxitur nga të ardhurat dalëse të investimeve.

Eksportet kanë pasur gjithashtu një rritje të lartë (36.7%). Në këtë rast, ndikimi kryesor ka ardhur nga eksporti i shërbimeve dhe më konkretisht eksportet e turizmit. Statistikat e shërbimeve kanë konfirmuar praninë e një sezoni mjaft të mirë turistik. Flukset hyrëse të shërbimeve të turizmit kanë tejkaluar për herë të parë nivelin e 1 miliard eurove në një tremujor të vetëm. Gjithashtu, rritje e fortë vihet re edhe në eksportin e mallrave (55.8%). Sikurse në rastin e importit të mallrave, efekti i rritjes së çmimeve ka qenë mbizotërues.

Llogaria e të ardhurave dytësore shënoi një suficit pothuaj të njëjtë me një vit më parë. Remitancat vazhdojnë të shënojnë rritje të fortë (8.3%). Nga ana tjetër, janë pakësuar flukset hyrëse të "Qeverisë së Përgjithshme".

Në llogarinë financiare, janë regjistruar detyrime neto në vlerën 44.0 milionë euro. Flukset hyrëse të investimeve direkte vazhdojnë të rriten me ritme të larta (32.2%). Stoku i rezervës në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022, është në gjendje të mbulojë 7.3 muaj import mallrash dhe shërbimesh ose 299.5% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

[1] *Në fund të materialit gjendet një tabelë përmbledhëse për zhvillimet kryesore të Bilancit të Pagesave gjatë periudhave të fundit përfshirë tremujorin në analizë.*

II. LLOGARIA KORRENTE

Deficiti i llogarisë korrente shënoi 166.0 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2022, duke u rritur me rreth 57.3% në terma vjetorë. Deficiti llogaritet në 3.5% të PBB-së ose rreth 0.8 pikë përqindje më i lartë se i njëjti tremujor i një viti më parë. Rritja e importeve dhe e të ardhurave parësore dalëse kanë qenë faktorët kryesorë pas zgjerimit të shpejtë të deficitit korrent.

Grafik 1. Kontributi sipas kategorive (pikë përqindje) në ecurinë vjetore të deficitit korrent (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e importeve ishte 31.0%, e nxitur nga zgjerimi i importit të mallrave me 29.8%. Rritja e fortë vjen si për shkak të zgjerimit të çmimeve ndërkombëtare ashtu edhe nga importi i lartë i energjisë elektrike (në sasi të mëdha dhe me çmime në rritje) si pasojë e vështirësive të prodhimit vendas. Kjo ecuri ka qenë e ngjashme edhe për gjysmën e parë të vitit 2022. **Edhe importi i shërbimeve paraqet rritje të lartë (33.9%).** Faktor kryesor mbeten flukset dalëse të turizmit, të cilat vazhdojnë të rriten me ritme të larta (38.3% në terma vjetorë).

Rritja e eksporteve (36.7%) ka amortizuar disi efektin importues. Rritja e flukseve hyrëse të shërbimeve (31.9%) dhe veçanërisht atyre të turizmit (34.9%) kanë dhënë shtysën kryesore në rritjen e eksporteve të përgjithshme duke dëshmuar për një sezon shumë të mirë turistik gjatë tremujorit të tretë. Paralelisht, edhe eksportet e mallrave paraqesin rritje të lartë (55.8%). Vlerësohet që ndikimi kryesor lidhet me rritjen e çmimeve ndërkombëtare, ashtu sikurse në rastin e importeve.

Deficiti i përgjithshëm tregtar në mallra dhe shërbime u zgjerua me rreth 6.1%, për shkak të efektit më të fortë importues. Ai qëndron në 7.7% ndaj PBB-së, me rënie 1.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Grafik 2. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të ardhurat parësore shënuan një deficit prej 80.7 milionë eurosh, pothuaj i dyfishuar në terma vjetorë. Flukset dalëse të investimeve (kryesisht atyre direkte) vazhdojnë të drejtojnë deficitin e nënllogarisë duke dëshmuar për performancën e mirë të kompanive të IHD-ve në vend. Nga ana tjetër, edhe të ardhurat hyrëse nga puna shfaqen me norma të larta rritjeje, por përsëri nuk janë në gjendje të kompensojnë efektin e të ardhurave nga investimet.

Grafik 3. Bilanci i të ardhurave parësore (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe të ardhurat nga investimet direkte (flukse neto, në milionë euro, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Suficiti i nënllogarisë së të ardhurave dytësore u ngushtua me rreth 0.1% në terma vjetorë. Rënia e flukseve hyrëse të "Qeverisë së Përgjithshme" ka dhënë ndikimin kryesor. Nga ana tjetër, remitancat hyrëse vazhdojnë të zgjerohen me ritme të larta (8.3%), ashtu sikurse edhe në tremujorët e mëparshëm.

Grafik 4. Dërgesat e emigrantëve (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe financimi i deficitit tregtar të mallrave nga të ardhurat neto parësore, dytësore dhe nga shërbimet (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1. ZHVILLIMET NË KURSIMET DHE INVESTIMET KOMBËTARE

Zgjerimi i raportit të deficitit korrent ndaj PBB-së në terma vjetorë ka ardhur kryesisht si pasojë e zgjerimit të hendekut kursime-investime në sektorin privat, si nga rënia e kursimeve ashtu edhe nga rritja e investimeve. Nga ana tjetër, situata paraqitet e përmirësuar në sektorin publik si pasojë e rënies së investimeve përkatëse.

Hendeku kursime-investime i sektorit privat u vlerësua në -3.6% të PBB-së, rreth 2.4 pikë përqindje më i thellë krahasuar me një vit më parë. Raporti i investimeve private ndaj PBB-së vlerësohet në nivelin 16.9%, rreth 0.9 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Kursimet private ndaj PBB-së vlerësohen në nivelin 13.3%, rreth 1.5 pikë përqindje më të ulëta se një vit më parë. Të dy komponentët kanë ndikuar në thellimin e hendekut të sektorit privat, me një impakt më të lartë nga kursimet.

Hendeku publik vlerësohet në 0.2% ndaj PBB-së, me përmirësim 1.6 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Kursimet publike vlerësohen në nivelin 4.4% ndaj PBB-së në nivel pothuaj të njëjtë me një vit më parë. Investimet publike u vlerësuan në 4.2% ndaj PBB-së, rreth 1.6 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Rënia e investimeve publike ka qenë përcaktuese në ngushtimin e hendekut përkatës, por nuk ka qenë në gjendje të kompensojë efektin nga sektori privat në zgjerimin e deficitit korrent.

Grafik 5. Kontributi i treguesve të investimeve dhe kursimeve në dinamikën e deficitit (majtas) dhe kontributi i tyre në ndryshimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instat, dhe vlerësime të autorit.

III. LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale shënoi një tepricë negative prej 6.6 milionë eurosh, nga një suficit prej 96.9 milionë eurosh një vit më parë. Përcaktuese ka qenë rritja e flukseve dalëse private, një ecuri e ngjashme me tremujorin e parë të vitit. Flukset kapitale neto në këtë llogari vlerësohen në -0.1% ndaj PBB-së.

Në tremujorin e tretë të vitit 2022, ekonomia jonë paraqet një pozicion neto huamarrës prej 172.7 milionë eurosh. Ky nivel rezulton 164.0 milionë euro më i lartë krahasuar me një vit më parë. Zgjerimi i pozicionit huamarrës ka ardhur si rezultat i përkeqësimit të llogarisë korrente dhe llogarisë kapitale.

IV. LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare regjistroi detyrime neto në vlerën 44.0 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë rezultonte me mjete neto në masën 95.8 milionë euro. **Flukset hyrëse të Investimeve Direkte vazhdojnë të shfaqin norma të larta rritjeje (32.2%) sikurse edhe përgjatë gjithë gjysmës së parë të vitit 2022.** Vihet re një mbështetje e lartë që vjen si nga riinvestimi i fitimeve sikurse ka ndodhur edhe në tremujorët e mëparshëm. Rritja është mbështetur kryesisht nga sektorët e "Industrisë nxjerrëse", "Energjisë" dhe "Pasurive të paluajtshme".

Grafik 6. Llogaria financiare dhe gabime e harresa (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në rastin e investimeve të portofolit vazhdon tendenca e pakësimit të detyrimeve. Sikurse gjatë gjysmës së parë të vitit, kjo lidhet përsëri me kalimin e pronësisë së "Eurobondit" nga jorezidentët te "Korporatat depozitëmarrëse". **Për sa i përket investimeve të tjera,** "Korporatat depozitëmarrëse" kanë shtuar mjetet dhe detyrimet në formën e "monedhave dhe depozitave". Nga ana tjetër janë pakësuar detyrimet e huasë për "Qeverinë e Përgjithshme" dhe "Korporatat depozitëmarrëse".

Grafik 7. Përbërësit e llogarisë financiare (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Raporti i financimit të deficitit korrent prej investimeve direkte neto



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një shtim të mjeteve të rezervës me 94.1 milionë euro. Në fund të muajit shtator 2022, stoku i rezervës valutore ishte 5.1 miliardë euro dhe vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 7.3 muajve import mallrash dhe shërbimesh ose 299.5% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto. Së fundi, zëri "gabime dhe harresa neto" rezultoi në një fluks hyrës prej 128.7 milionë eurosh, i cili llogaritet në 2.7% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 9. Gabime dhe harresa ndaj PBB-së nominale (% majtas) dhe ndaj deficitit të llogarisë korrente (%, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Instat.

V. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT

Profili i financimit të deficitit korrent, përcaktohet nga ecuria e flukseve hyrëse borxh-krijuese, kundrejt flukseve hyrëse joborxhkrijuese[2]. Flukset financiare joborxhkrijuese nga investimet direkte neto dhe nga llogaria kapitale u vlerësuan në nivelin 6.1% ndaj PBB-së nominale. Këto ishin rreth 2.7 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Flukset financiare borxhkrijuese u vlerësuan në nivelin -3.4% ndaj PBB-së nominale, rreth 1.0 pikë përqindje më të larta krahasuar me një vit më parë.

Pasi flukseve valutore neto borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese u shtohen edhe gabimet dhe harresat neto, përftohet masa e financimit të përgjithshëm të deficitit korrent. Gjatë tremujorit në analizë, raporti i financimit të llogarisë korrente ishte në nivelin 156.7%, duke u përkthyer në një zgjerim të mjeteve të rezervës.

[2] *Kjo ndarje shërben për të monitoruar ndikimin që flukset financiare e kapitale kanë në borxhin e jashtëm të vendit. Flukset joborxhkrijuese përfshijnë Investimet Direkte dhe hyrjet neto të llogarisë kapitale, ndërsa flukset borxh-krijuese përfshijnë investimet e portofolit dhe investimet e tjera neto.*

Grafik 10. Flukset hyrëse financiare borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe financimi në total i deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T1'21	T2'21	T3'21	T4'21	T1'22	T2'22	T3'22
Llogaria Korrente (në mil euro)	-292.8	-227.4	-105.5	-540.6	-248.9	-206.2	-166.0
vmv (%)	24.6	-39.8	-44.8	55.1	-15.0	-9.3	57.3
/ PBB-së (%)	-8.7	-5.6	-2.7	-13.2	-6.2	-4.3	-3.5
Mallra dhe shërbime	-477.5	-406.0	-347.2	-802.7	-407.6	-396.9	-368.5
vmv (%)	24.2	-21.5	-22.4	37.9	-14.6	-2.2	6.1
Eksporte, f.o.b.	850.9	1184.9	1509.3	1205.5	1348.3	1724.5	2063.6
vmv (%)	0.4	142.7	77.0	44.9	58.5	45.5	36.7
Importe, f.o.b.	1328.4	1590.9	1856.5	2008.3	1755.8	2121.4	2432.1
vmv (%)	7.8	58.3	42.8	42.0	32.2	33.3	31.0
Udhëtime neto	101.4	186.8	384.6	167.2	85.8	251.7	505.4
Të ardhura parësore	-62.4	-74.9	-41.8	-31.8	-84.7	-69.2	-80.7
Kredi	84.1	85.0	105.4	123.0	118.6	143.3	148.8
Debi	146.5	160.0	147.2	154.9	203.3	212.4	229.5
Të ardhura neto nga Investimet Direkte	-118.8	-118.6	-120.6	-116.8	-168.2	-164.3	-183.0
Të ardhura dytësore	247.1	253.5	283.5	293.9	243.3	259.8	283.2
Kredi	286.4	293.8	327.3	336.5	284.1	303.9	330.8
Debi	39.4	40.3	43.8	42.6	40.8	44.1	47.6
Dërgesa nga emigrantët -neto	168.5	171.2	199.3	221.9	184.1	192.0	215.9
vmv (%)	10.6	41.6	1.0	9.5	9.2	12.2	8.3
Llogaria Kapitale	98.0	50.5	96.9	113.8	9.5	-5.9	-6.6
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-194.8	-176.9	-8.6	-426.8	-239.4	-212.1	-172.7
Llogaria financiare	-242.1	-132.7	95.8	-349.4	-312.4	-286.7	-44.0
vmv (%)	-9.7	-54.3	-197.3	81.3	29.0	116.0	-145.9
/ PBB-së (%)	-7.2	-3.2	2.5	-8.5	-7.8	-6.0	-0.9
Investime direkte	-223.6	-226.5	-249.8	-290.1	-271.4	-287.0	-300.3
vmv (%)	0.9	-1.0	11.9	32.0	21.4	26.7	20.2
Investime portofoli	120.0	82.9	145.6	-444.9	136.7	77.4	84.6
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	1.0	2.0	3.0	4.0
Investime të tjera	-213.0	128.2	-52.3	-341.0	-88.6	-13.7	77.6
Mjetet e rezervës	74.5	-117.3	252.4	726.6	-88.9	-63.3	94.1
Gabime dhe harresa	-47.2	44.2	104.4	77.4	-73.0	-74.5	128.7

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe vlerësime të autorit.